

Rezultatet e sondazhit televiziv për sezonin 2017-18

Me hapjen e grupit '[Maniakë t'Televizionit](#)', tek Maniakat kemi organizuar sondazhin për të marrë një pamje më të qartë të sektorit televiziv në vendin tonë.

Sondazhi është organizuar në dhjetë-ditëshin e parë të qershorit, dhe është shpërndarë vetëm në grupet e Maniakave. Janë përgjigjur 593 veta, shifër e cila kemi konsideruar se mjafton për të siguruar një pasqyrë fillestare për televizionet tona.


Tek Maniakë t'Televizionit planifikohet të mbahen sondazhe dy herë në vit, në përfundim të vitit kalendarik (dhjetor-janar) dhe në përfundim të sezonit televiziv (qershor-korrik). Ndërkohë 'polls' dhe opinionet e përdoruesve të Facebookut do të kemi rregullisht.

Rezultatet më të detajuara janë në dispozicion për përdorim të brendshëm dhe botim të kohëpaskohshëm tek grupi në fjalë. Këto pritet të jenë rezultate të ndara sipas moshës, gjinisë, rajonit.

1. Platforma sportive e preferuar

Rezultate ndoshta pak befasuese duke pasur parasysh që 14.53% e të pyeturve kanë anashkaluar këtë pyetje, ose janë përgjigjur që nuk shikojnë asnjë pako sportive. Kjo i afrohet pozitës së dytë, që befasisht mbajnë kanalet Eurosport.

Ende në krye, por me një rënie përqindjeje në krahasim me sondazhet paraprake të përgatitura në grupet e Maniakëve, qëndron SuperSport Kosova. ArtSport për një kohë të shkurtër ka marrë 1.35%, gjersa Kujtesa Sport kalon 10%.




2. Kanalet filmike të preferuara

Gati gjysma e kosovarëve shikojnë filma online. Mbi 43% e tyre në mënyrë ilegale! Opsioni Online/Filma24, me këtë të fundit të dhënë më shumë si shembull, ka marrë 42.16% të votave në kategorinë se ku anëtarët e grupeve Maniakët shikojnë filma. Online shikojnë filma edhe 2.36% e votuesve, të cilët në përgjigjen e tyre kanë dhënë edhe Netflixin si opsion. Gati 4% kanë anashkaluar përgjigjen duke nënkuptuar jo-interesimin për të shikuar filma.

Në kanalet lineare, ato të Digitalb dominojnë me 32.04% të votave. Më shumë se trefishin e kanaleve Tring të cilat vendosen në pozitën e dytë tek kanalet lineare me 9.11%. Kanalet Fox kanë 7.76%.


Platformat tjera nuk kanë marrë më shumë se 1% të votave.



3. Kanali informativ i preferuar

Njëra ndër kategoritë më të populluara me opsione ka qenë kategoria e televizioneve informative, prej të cilave janë zgjedhur ato që janë parë si më të popullarizuara. Edhe këtu ka qenë opsioni për të votuar për opsionet që nuk kanë qenë në listë, duke marrë vota edhe emisione si Fox News, e Report TV.

Për një margjinë më të vogël se 3%, CNN del kanali informativ më i besuar, para BBC World News. Tek kanalet vendore, Top News renditet para Arta, dhe ABC News.




4. Seriali më i mirë vendor

Gati 3% të votuesve kanë shprehur mllef në cilësinë e serialeve vendore. Këtë pyetje e kanë anashkaluar 5.56% të votuesve, që është më shumë se dy opsione që janë ofruar në sondazh – Hamdiu&Shyhretja dhe Tre Gjermanët e trashë!


Tek kjo kategori, Schengen Visa e cila nuk ka qenë e përfshirë si opsion, ka marrë gati 4% të votave duke u shtuar vet si opsion nga pjesëmarrësit.

O Sa Mirë! në Klan Kosova mbetet më i miri, derisa dy serialet e GjirafaVideo vendosen në podium, para Çka ka Shpija?!



5. Programi më i mirë argëtues


Tek programet argëtuese, Oxygen me Besim Dinën ka marrë përqindjen më të madhe në të gjitha kategoritë. Me 72.01%, Oxygen edhe pse me sezon të shkurtuar la mbrapa Odeonin, Superfidën, e Double Trouble të cilët së bashku kanë marrë 3.71% të votave. NIN, ndonëse më shumë ngjan në debat serioz së fundmi, është futur në këtë kategori si një emision argëtues!




6. Programi më i mirë informativ-aktual

Gjersa programet në nivel nacional për qytete tjera mungojnë, programet për Prishtinën janë me bollëk. Megjithatë, dy nga to nuk arrijnë të marrin së bashku sa 39.46% të votave që kanë shkuar për Info Magazine në Klan Kosova. Udhëve në RTK ka marrë 10.46% të votave, gjersa gati 1/5 e votuesve ka anashkaluar këtë pyetje.

Programi më i mirë informativ-aktual



7. Programi më i mirë hulumtues




Prodhimi i BIRN, emisioni Drejtësia në Kosovë ka qenë programi që ka marrë më shumë se 60% të votave, duke lënë konkurrencën e re goxha mbrapa. Prodhimi i vetëm i Gazeta Insajderi, 'Indoks është renditur i dyti.

8. Programi më i mirë politik-debatues

Ndoshta dueli më i ngushtë në këtë sondazh ka qenë në këtë kategori. Në fund, Jeta Xharra ka marrë rreth 30 vota më shumë se Adriatik Kelmendi, me konkurrencën të cilët së bashku nuk kanë arritur votat e të dyve. Zona B e Zona e Debatit janë renditur në pozitën e tretë.


Programi më i mirë politik-debatues



9. Programi më i mirë për film

Primati në programin më të mirë për film i takoi Telekinos. Më shumë se çereku i pjesëmarrësve në sondazh kanë anashkaluar këtë pyetje, duke e bërë njërën nga kategoritë me interesimin më të vogël. Kjo më shumë mund të përkthehet në kualitetin e dobët të programeve të filmit në televizionet tona.


Programi më i mirë për film



10. Programi më i mirë për kuzhinë


Fillimisht në këtë kategori kanë qenë të përfshira nga një program nga secili kanal. Kështu që nga RTV21, 'Çka ka me hongër?' është vendosur në opsionet e ofruara, derisa votat për 'Diçka po zihet' kanë ardhur nga opsioni 'tjera'. Sidoqoftë, 'Te Linda' ka marrë gati gjysmën e votave duke u përzgjedhur si programi më i mirë me tematikë ushqimin.

Programi më i mirë për kuzhinë



11. Programi më i mirë ekonomik


Puls me Mefail Bajqinovcin ka qenë programi më i votuar me tematikë ekonominë. Kanë vijuar Standardi Ynë dhe Eurotribuna, që të dyja më pak vota se sa votues që kanë anashkaluar këtë pyetje.



12. Programi më i mirë për të rinj


Wazzup i Klan Kosova është emisioni i preferuar tek gati gjysma e të rinjve që kanë votuar në këtë sondazh. Pason Reload i Dukagjinit, derisa 3.2% nuk shohin këso emisionesh.

Programi më i mirë për të rinj



13. Gara më e mirë sportive në TV


Liga e Kampionëve është gara sportive kampione në TV. Me më shumë se 40% të votave, gara që transmetohet në K-Sport, lë mbrapa konkurrentët e SuperSport me Premier League. La Liga vijon e treta, derisa gara e katërt më e mirë ka qenë Olimpiada Dimërore e transmetuar në Eurosport gjatë muajit shkurt, para NBA-së. Serie A është vetëm e gjashta me 1.69%.



14. Programi më i mirë informues-sportiv

Ndërkohë tek programet sportive, 'Sporti në KTV' vazhdon të dominojë këtë kategori para 'Minuta e fundit'. Gati 15% e pjesëmarrësve nuk kanë interesim për t'u informuar rreth sportit në TV.


Programi më i mirë informues-sportiv



15. Programi më i mirë lifestyle-showbiz

Prive i Klan Kosova është emisioni me fitoren më bindëse të dytë në këtë sondazh. Me 72.51% të votave, Prive lë pas EliteShow, derisa vetëm 13% nuk shikojnë emisione me këtë tematikë.


15. Programi më i mirë lifestyle-showbiz



16. Programi më i mirë sportiv

Edhe tek programi javor sportiv KTV dominon konkurrencën me 'Sporti Total'. Por, mbi 20% të votuesve nuk kanë dhënë përgjigje në këtë pyetje. 2me1 i RTV21 është renditur i dyti, para Arenës. AS ka marrë 2.36%, ndërkohë SportShow i Klan Kosova vetëm 0.87%


Programi më i mirë sportiv



17. Programi talk-show më i mirë familjar

Dy emisionet e Klan Kosova, Familja Ime dhe Mësimet e Diolës kanë marrë dy të tretat e votave, gjersa Shëndeti i Dukagjini TV mbetet me vetëm 12.69% në kategorinë e emisioneve familjare.


Programi talk-show më i mirë familjar



18. Talk-Show më i mirë argëtues


Labi ka marrë shikuesit me vete në Kohavision. 1KL mbetet talk show më i mirë argëtues, para Natën, dhe 1 Kafe prej Shpisë. Edhe tek kjo kategori, mbi 20% nuk kanë votuar, gjersa 6.75% kanë deklaruar se asnjëri show nuk është argëtues për ta.

TALK-SHOW MË I MIRË ARGËTUES



19. Programi më i mirë i pasdites


Pasditja i takon Klan Kosovës. 'Ora e Pasdites' renditet e para, me pak më shumë se 4% diferencë ndaj Express KTV. Bon Bon vijon vonë larg në pozitën e tretë për emisionet, pa llogaritur 11% të anashkalimeve.



20. Programi më i mirë i mëngjesit

Kosovarët zgjohen me Ora7. Janë 42.5% të kosovarëve që preferojnë këtë program, gjersa 10% nuk zgjohen në mëngjes. Mirëmëngjesi Kosovë dhe Express Morning vijnë me nga 9%, pasuar nga Zyra e Ankesave dhe Për ditë të mbarë me 8%.


Programi më i mirë i mëngjesit



21. Programi më i mirë informues


Edicioni qendror i lajmeve në Klan Kosova ka dalë në sondazh me më së shumti vota duke lënë pas dy edicionet e lajmeve të KTV-së, Interaktivin dhe Lajmet e orës 19, të cilat as së bashku nuk arrijnë përqindjen e Lajmet 20/00. Lajmet e RTK-së mbeten në pozitën e katërt, gjersa Lajmet e TV Dukagjini janë të fundit në këtë kategori që kalojnë shifrën prej 1%.

Programi më i mirë informues




22. Kanali lifestyle i preferuar

LivingTV është kanali i preferuar në zhanrin lifestyle. Viojnë dy kanalet e Discoveryt TLC dhe ID që më shumë është kanal kriminalistik se lifestyle. Gati 15% anashkalan këtë pyetje, gati e njëjta përqindje me ata që shikojnë 24Kitchen.




23. Kanalet më të mira dokumentare

Tek kanalet dokumentare, National Geographic ka lënë në luftë të ngushtë Explorer dhe Discovery kanalet, me Tring që kalojnë 10%.




24. Kanali rajonal më i mirë

Tri kanale rajonale ndajnë 85% të 'pites' së kanalit rajonal më të mirë. Top Channel prin para Klan TV, dhe Alsat M. Vizion Plus është i vetmi që kalon 'pragun' me mbi 5%.



25. Kanali kosovar më i mirë


Sondazhi ynë si kanalin më të mirë kosovarë për grupet Maniakat nxjerr Klan Kosovën me gati 50% të votave. Kohavision ka marrë gati çerekun e votave të përgjithshme, duke bërë që 75% e tregut të kanaleve kosovare kombëtare të mbulohet nga dy kanale. RTV21 është e treta me RTK1 dhe TV Dukagjini që ndahen me një diferencë minimale.



26. Operatori satelitor

Pa operator satelitor adekuat, përjashto AlbanicaSat që ka marrë vetëm 0.17% të votave në pjesën e opsioneve tjera, 73% të pjesëmarrësve kanë anashkaluar pyetjen në operatorin satelitor që posedojnë. Digitalb prin me pak nën 20%, me Tring Digital që kalon 4%. Më pak se 1% kanë dhënë përgjigje për marrjen e sinjalit në mënyra tjera ilegale me satelit.

Operatori satelitor



27. Operatori kabllor

Tek operatorët kabllor, gjithnjë sipas sondazhit të Maniakave, Ipko zotëron 48.5% të tregut, para Kujtesa që ka 20.5%, dhe Telekom i Kosovës që ka 5.9%. OrangeNet ka 4.9%, gjersa ArtMotion renditet e pesta me 3.2%. Operatorët lokal kanë në total 4.2%, nga ta EGC me 0.8% më i popullarizuari.

Operatori kabllor

